



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Njesisë së Personelit

1. Me këtë vendim, Agron Thaqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar i Personelit në Njësinë e Personelit, **caktohet** Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Njesisë së Personelit, në Komunën e Rahovecit, nga data 1.11.2023, deri më datë 1.5.2024.
2. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Njesisë së Personelit, janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.
3. Të lartpërmendurit sipas pikës 1 të këtij vendimi, do t'i takojë kompensimi i pagës së Udhëheqësit të Njesisë së Personelit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se pozita e Udhëheqësit të Njesisë së Personelit në Komunën e Rahovecit është i lirë (vakant), si dhe duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve dhe të detyrave të cilat dalin nga vendi i punës në Njësinë e Personelit, është i domosdoshëm caktimi i Ushtruesit të Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë së Personelit.

Andaj, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Agron Thaqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar i Personelit në Njësinë e Personelit, caktohet Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Njesisë së Personelit në Komunën e Rahovecit, nga data 1.11.2023, deri më datë 1.5.2024. Andaj, bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Vendimi u dërgohet:

- **Agron Thaqi,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,**
- **Njesisë së Personelit, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Ushtrues Detyre i Shefit të Sektorit të Gjendjes Civile

1. Me këtë vendim, Petrit Haxhijaha, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, në Drejtorinë për Administratë, **caktohet** Ushtrues Detyre i Shefit të Sektorit të Gjendjes Civile, në Drejtorinë për Administratë, në Komunën e Rahovecit, nga data 1.11.2023, deri më datë 1.5.2024.
2. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Shefit të Sektorit të Gjendjes Civile janë të përcaktuara me Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit, me Nr. Prot. 01 Nr. 1092, e datës 27.3.2015.
3. Të lartpërmendurit sipas pikës 1 të këtij vendimi, do t'i takojë kompensimi i pagës së Shefit të Sektorit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh se pozita Shef i Sektorit të Gjendjes Civile, në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit është i lirë (vakant), si dhe duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve dhe të detyrave të cilat dalin nga vendi i punës në Sektorin e Gjendjes Civile, është i domosdoshëm caktimi i Ushtruesit të Detyrës së Shefit të Sektorit të Gjendjes Civile, në Drejtorinë për Administratë.

Andaj, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Petrit Haxhijaha, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, caktohet Ushtrues Detyre i Shefit të Sektorit të Gjendjes Civile, në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit, nga data 1.11.2023, deri më datë 1.5.2024.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Vendimi u dërgohet:

- **Petrit Haxhijahës,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,**
- **Njësisë së Personelut, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Ushtrues Detyre i Drejtorit të QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec

1. Me këtë vendim, Elbunit Kryeziu, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Mjek në sektorin e mjekësisë familjare në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, **caktohet** Ushtrues Detyre i Drejtorit të QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, nga data 1.11.2023, deri më datë 1.5.2024.
2. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, janë të përcaktuara në Statutin e QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec me Nr. Prot. 01, Nr. 381/22, i datës 28.10.2022.
3. Të lartpërmendurit sipas pikës 1 të këtij vendimi, do t'i takojë kompensimi i pagës së Drejtorit të QKMF-së.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se pozita e Drejtorit të QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec është i lirë (vakant), si dhe duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve dhe të detyrave të pozitës së Drejtorit në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, është i domosdoshëm caktimi i Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit në këtë institucion.

Andaj, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Elbunit Kryeziu, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Mjek në sektorin e mjekësisë familjare në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, caktohet Ushtrues Detyre i Drejtorit të QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, nga data 1.11.2023, deri më datë 1.5.2024.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim, ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit, Komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- Elbunit Kryeziut,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Njesisë së Personelit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESIDENKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 3256 Nr. i faq./Br. str./No. pg. 38
Data/Data/Date 23/10/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Zhvendosja e rjetit dhe trafos në sheshin qendror", me numër të kontratës: 623-23-5687-5-2-1/C519, si në vijim:
 - 1.1. "P.M.N." Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Albnor Mullabazi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblërjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblërjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblërjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i kontratës,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit, dhe**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetar i Komitës
Zyrtar Kryesor Administrativ





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Furnizim me inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP-së", me numër të kontratës: 623-23-1684-1-2-1/C517, si në vijim:
 - 1.1. Qamil Sylka, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Depoist, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Besnik Hoti, drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimi të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërbljerjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërbljerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërbljerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i kontratës,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit, dhe**
- **Arkivi.**


Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KOMUNË RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/PRIDRUŽENJE OPŠTINSKOGA KANCELARIJA
Njësia Nr./Br.No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br.No 3258 Nr. i faq/Br.st/No.pz 38
Data/Datum/Data 24.10.2023
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për verifikimin e kulturës në parcelë

1. **Caktohet** komisioni për verifikimin e kulturës në parcelën e fermerit Fikri Shehu, sipas kërkesës me Nr. Prot. 5858, e datës 24.10.2023, si dhe fermerit Mejdi Shehu, sipas kërkesës me Nr. Prot. 5857, të datës 24.10.2023, në këtë përbërje:

- 1.1. Ilvi Durguti, kryesues,
- 1.2. Hasan Vuçitërna, anëtar,
- 1.3. Veton Mustafa, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë verifikimin e kulturës në parcelën e fermerit Fikri Shehu, sipas kërkesës me Nr. Prot. 5858, e datës 24.10.2023, si dhe të fermerit Mejdi Shehu, sipas kërkesës me Nr. Prot. 5857, të datës 24.10.2023.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 31.10.2023.
5. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DBPZHR-së, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



projekti, pasi disa pozicione nuk kanë nevojë të punohen, ndërsa në disa pozicione të caktuara duhet zvogëluar sasia.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, përmes kërkesës dhe rekomandimit të datës 6.10.2023 dhe rekomandimit të mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë, me Nr. Prot. 5686, të datës 24.10.2023, ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ, ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull: "Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit - ritenderim", me Nr. të Prokurimit: 623-22-6778-5-2-1/C445 dhe atë:

- Paramasa dhe parallogaria për ndërtimin e sheshit qendror të qytetit në Rahovec: Nga pozicionet TABELA A: 3 - Pozicioni 3.1, 3.6, dhe 3.9; 4 - Pozicioni 4.9, në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA A: 4 - Pozicioni 4.1, 4.2, 4.4 dhe 4.5, pa implikime financiare shtesë;
- Paramasa dhe parallogaria për ndërtimin e parkingjeve: Nga pozicionet TABELA A: 3 - Pozicioni 3.2, 3.3, 3.5, 3.6, 3.8 dhe 3.9, 7 - Pozicioni 7.4, 7.5 dhe 7.6, në pozicionet e domosdoshme për realizim TABELA A: 3 - Pozicioni 3.1, 3.4 dhe 3.7; 5 - Pozicioni 5.1 dhe 5.2, pa implikime financiare shtesë; dhe
- Paramasa dhe parallogaria për ndërtimin e tregut ditor: Nga pozicionet TABELA A: 3 - Pozicioni 3.5, 3.6, 3.8, 3.10 dhe 3.11, 5 - Pozicioni 5.2, 6 - Pozicioni 6.1 dhe 6.2, 7 - Pozicioni 7.2, 7.4, 7.5, 7.6 dhe 7.7, në pozicionet e domosdoshme për realizim TABELA A: 3 - Pozicioni 3.1 dhe 3.2, pa implikime financiare shtesë.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të vazhdimit të punimeve të këtij projekti, pasi disa pozicione nuk kanë nevojë të punohen, ndërsa në disa pozicione të caktuara duhet zvogëluar sasia, me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtëpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- ***Menaxherit të Kontratës,***
- ***Mbikëqyrësit të Drejtëpërdrejtë,***
- ***Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



1.	2023.09.24
2.	362
3.	39
Da.	25.10.23
R.	

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe i printerëve me qira”, me Nr. prokurimi: 623-23-11127-2-2-5 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-069-5-2-5, të datës 24.10.2023, në këtë përbërje:
 - 1.1. Bekim Krasniqi, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Enise Dina, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: “Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe i printerëve me qira”, me Nr. prokurimi: 623-23-11127-2-2-5 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-069-5-2-5, të datës: 24.10.2023.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I PRESIDENKUT OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 3263 Nr. ifaq/Br.str./No.pg 39		
Data/Datum/Date 25/10/23		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 60 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.08/L-197, nenit 10 të Rregullores (QRK) NR.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e zyrtarëve publikë, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT DISIPLINOR

1. Me këtë vendim **CAKTOHEN** anëtarët e Komisionit Disiplinor të Shërbimit Civil të Administratës komunale të Rahovecit, si në vijim:
 - 1.1. Skender Hamza, kryesues,
 - 1.2. Bjondina Ramaj, anëtare,
 - 1.3. Agron Thaqi, anëtar.
2. Detyrat e Komisionit Disiplinor janë të përcaktuara me Ligjin mbi Shërbimin Civil të Kosovës Nr.08/L-197 dhe nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e zyrtarëve publikë.
3. Mandati i anëtarëve të Komisionit Disiplinor është 2-vjeçar, me mundësi vazhdimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen anëtarët e Komisionit Disiplinor.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e Komisionit Disiplinor,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 22 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.4.2017, neneve 74 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHET** kërkesa me Nr.5854, e datës 24.10.2023, e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dega Rahovec dhe i lejohet furnizimi me derivate të naftës, në sasi prej 50 L (pesëdhjetë litra), për nevojat lidhur me aktivitetet e shoqatave të dala nga lufta për manifestimet dhe për përvjetorët e dëshmorëve (nderimet), për muajin nëntor.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U dërgohet :

- ***OVL-UÇK-së, dega në Rahovec,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINETI I PRESIDENCA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S OFFICE

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 3264 Nr. i faq./Br.ste/No.pg 39

Data/Datum/Date 26 / 10 / 23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-23-10697-2-2-1, dhe Nr. të brendshëm: 623-23-067-2-2-1, të datës: 25.10.2023, në këtë përbërje:**

- 1.1. Artan Asllani, kryesues,
- 1.2. Mimoza Ejupi, anëtare,
- 1.3. Vjollca Berisha, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-23-10697-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-067-2-2-1, të datës 25.10.2023.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/20080) nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shpërndarjen e drunjve për familjet në nevojë

1. Caktohet komisioni për shpërndarjen e drunjve të siguruar nga prerja e plepave te çerdhja “Tulipanët” në Rahovec, në këtë përbërje:

1.1. Brikena Osa, kryesuese,


1.2. Luan Sharku, anëtar,

1.3. Jetmir Ukaj, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë shpërndarjen e drunjve të siguruar nga prerja e plepave te çerdhja “Tulipanët” në Rahovec.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë një raport me shkrim dhe një ekzemplar t'ia dorëzojë kryetarit të Komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria Komunale për Arsim.
7. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë Komunale për Arsim
- Arkivit.





Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim publik në Republikën e Kosovës, neni 72 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik me Nr.82/2022 i datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të projektit me Nr. 85, të datës 25.10.2023 për ndërprerjen e Kontratës me titull **“Riparimi i monumenteve kulturore - historike dhe terrenet sportive LOT 2”**, me nr. të kontratës: 623-21-4944-5-2-1/C315, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titullin “Riparimi i monumenteve kulturore - historike dhe terrenet sportive LOT 2”

1. **APROVOHET** kërkesa e menagjerit të Projektit dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, me Nr. 85, të datës 25.10.2023, për ndërprerje me marrëveshje të Kontratës, me titull **“Riparimi i monumenteve kulturore – historike dhe terreneve sportive LOT 2”**, me nr. të kontratës: 623-21-4944-5-2-1/C315.
2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanshme, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të rrethanave krijuara në nivelin global lidhur me ndryshimin e çmimeve të produkteve ndërtimore të shkaktuara pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme komfor dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim autoriteti kontraktues), ka nënshkruar kontratën me grupin e Operatorëve Ekonomikë N.N.P. **“VETONI”** dhe **T&DESINNG SH.P.K.** Sopniq – Rahovec, me titull: **“Riparimi i monumenteve kulturore - historike dhe terrenet sportive LOT 2”**, me nr. të kontratës: 623-21-4944-5-2-1/C315, të nënshkruar më 17.9.2021.

Pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktues ka filluar të kryejë punët sipas kushteve të parapara në kontratë, mirëpo, për shkak të rrethanave të krijuara në nivelin global lidhur me ndryshimin e çmimeve të produkteve ndërtimore të shkaktuara pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.

- Për këtë arsye grupin e Operatorëve Ekonomik N.N.P „ VETONI “ dhe T&DESINNG SH.P.K. Sopniq – Rahovec ka parashtruar **kërkesë me nr. 5864, të datës 24.10.2023** për ndërprerjen e kontratës me titull “Riparimi i monumenteve kulturore - historike dhe terreneve sportive LOT 2”, me nr. të kontratës: 623-21-4944-5-2-1/C315, të nënshkruar më 17.9.2021.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, me Nr. 85, të datës 25.10.2023 për ndërprerjen me marrëveshje të kontratës me titull “Riparimi i monumenteve kulturore - historike dhe terrenet sportive LOT 2” me nr. të kontratës: 623-21-4944-5-2-1/C315.

Pas kërkesës së pranuar nga grupi i Operatorëve Ekonomikë N.N.P “VETONI” dhe T&DESINNG SH.P.K. Sopniq – Rahovec **me nr. 5864, të datës 24.10.2023** për ndërprerjen e Kontratës me titull “Riparimi i monumenteve kulturore - historike dhe terrenet sportive LOT 2”, me nr. të kontratës 623-21-4944-5-2-1/C315 dhe rekomandimit të Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të kontratës për ndërprerjen e kontratës me titull „Riparimi i Monumenteve Kulturore -Historike dhe Terrenet sportive LOT 2 “me Nr. të Kontratës 623-21-4944-5-2-1/C315 për shkak të rrethanat e krijuara në nivelin global lidhur me ndryshimin e çmimeve të produkteve ndërtimore të shkaktuara pas datës kur kontrata ka hyr në fuqi.

- Pas administrimit e të gjitha provave , Kryetari i Komunës ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerje e Kontratës me titull „Riparimi i Monumenteve Kulturore -Historike dhe Terrenet sportive LOT 2 “me Nr. të Kontratës 623-21-4944-5-2-1/C315.

Me vendim të njoftohen :

- 1. Zyra e Prokurimit***
- 2. Menaxheri i Projektit***
- 3. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherit të projektit dhe***
- 4. Arkivi***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3269 Nr. i fag./Br. str./No. pg 39

Data/Datum/Date 27/10/2023

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 34 të Ligjit Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

- Formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimin në punë të një Specialisti ligjor, sipas Konkursit RN00012601, për pozitën: Zyrtar ligjor në Zyrën Ligjore. në Zyrën e Kryetarit të Komunës, në këtë përbërje:
 - Isak Hoti, kryesues,
 - Mirsad Shala, zëvendësues,
 - Agron Thaqi, anëtar,
 - Fjolla Duraku, zëvendësuese,
 - Skender Hamza, anëtar,
 - Senad Mullaavda, zëvendësues,
 - Njomza Fazliu, anëtare,
 - Flutura Beqiri, zëvendësuese,
 - Skender Kokollari, anëtar (ekspert).
- Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDNIKA OPŠTINE / MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3273 Nr. i faq./Br. str./No. pg 40
Data/Datim/Date 30/10/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për rishikimin e ndryshimit dhe të plotësimit të Planit për Integritet, të Komunës së Rahovecit

1. **Caktohet** Grupi Punues për rishikimin e ndryshimit dhe të plotësimit të Planit për Integritet, të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Valmir Gashi, kryesues,
 - 1.2. Blerta Gashi, anëtare,
 - 1.3. Skender Hamza, anëtar,
 - 1.4. Mirsad Shala, anëtar,
 - 1.5. Qëndresa Duraku, anëtare.
2. Grupi Punues ka për detyrë që të bëjë rishikimin e ndryshimit dhe të plotësimit të Planit për Integritet të Komunës së Rahovecit.
3. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues,
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KRYETARI I KRYETARIT TE KOMUNES/PRESIDNIK OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR	
Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No. 3274	Nr. i fag./Br.str./No. pg. 40
Data/Datum/Date 30/10/23	
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Rregullimi i rrjetit kryesor dhe sekondar të ujësjellsit në objektin e IAAP 'Selajdin Mullaabazi – Mici", me numër të kontratës: 623-23-10646-5-3-6/C521, si në vijim:
 - 1.1. "P.M.N." Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Avni Morina, drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimi të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës

nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblertjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblertjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblertjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit, dhe
- Arkivi.


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**



Republika e Kosovës / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
Opština ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI / KABINET / KABINET
Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 3277 Nr. i faq./Br. str./No. pg. 40
Data/Datum/Date 30.10.23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 37 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Rregullores (QRK) Nr. 06/2023 për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqësimit, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Me këtë vendim, i **lejohet** udhëtimi zyrtar z. Lendrit Qeli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Rahovecit.
2. Lendrit Qeli do të marrë pjesë në takimin e 16-të të dialogut mbi komunitetet rom dhe jorom "Execution of Roma and Traveller-related judgments of the European Court of Human Rights/ Ekzekutimi i vendimeve të lidhura me romët dhe udhëtarët nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut" që do të mbahet në Këshillin e Evropës në Strasburg, nga data 13 nëntor 2023, deri më datë 16 nëntor 2023.
3. I lartpërmenduri ka të drejtë të udhëtojë zyrtarisht dhe të zgjedhë mënyrën e udhëtimit varësisht nga organizimi, si dhe ka të drejtë të kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset i lartpërmenduri dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Z. Lendrit Qeli,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E RAHOVECI
KRYETARI I KOMUNES
Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS
Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 3286 Nr. i faq./Br. str./No. pg. 41
Data/Date/Dat.: 31 / 10 / 2023
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kontratës me titull "Ndërtimi i AMF-së në Lagjen e Epërme", me Nr. të Prokurimit: 623-21-1546-5-2-1 dhe Kërkesës së menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, me Nr. Prot. 5927, të datës 31.10.2023, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull "Ndërtimi i AMF-së në Lagjen e Epërme", me Nr. të Prokurimit: 623-21-1546-5-2-1

1. Me këtë vendim, **lejohe**t ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Ndërtimi i AMF-së në Lagjen e Epërme" me Nr. të Prokurimit: 623-21-1546-5-2-1.
2. Ndërrimi i pozicioneve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të bëhet nga pozicionet e kontratës: Pozicioni 14.13, 14.22, 15.12, 10.8, 4.6, 1.20 dhe 9.11, në pozicionet e domosdoshme për realizim: Pozicioni 5.4, 10.1, 11.1, 14.19, 4.18 dhe 14.21, pa implikime shtesë financiare.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi), i kontratës me titull "Ndërtimi i AMF-së në Lagjen e Epërme", me Nr. të Prokurimit: 623-21-1546-5-2-1, me kërkesën me Nr. Prot. 5919, të datës 30.10.2023, u ka rekomanduar menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të përfundimit të këtij projekti.

Pas kësaj, menaxheri i Kontratës, përmes mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, ka parashtruar kërkesën me Nr. Prot. 5927, të datës 31.10.2023, me anë të së cilës ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ, ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Ndërtimi i AMF-së në Lagjen e Epërme", me Nr. të Prokurimit: 623-21-1546-5-2-1 dhe atë nga pozicionet e kontratës: Pozicioni 14.13, 14.22, 15.12, 10.8, 4.6, 1.20 dhe 9.11, në pozicionet e domosdoshme për realizim: Pozicioni 5.4, 10.1, 11.1, 14.19, 4.18 dhe 14.21.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të përfundimit të projektit, me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me menaxherin e kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës që të bëhet pa implikime financiare shtesë.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, ekipin për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- *Menaxherit të kontratës,*
- *Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë,*
- *Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,*
- *Njësisë së Prokurimit, dhe*
- *Arkivit.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

